



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 181 / Prot.

Tiranë, më 01/2 /2017

Lënda : Dhënie mendimi për projektin e instalimit të sistemit CCTV në Zyrat e Gjendjes Civile.

Drejtuar: **Z. Genci GJONÇAJ**

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Tiranë

I nderuar Z. Gjonçaj,

Referuar kërkesës tuaj vlerësojmë se në parim nuk ka asnjë pengesë ligjore për vendosjen e sistemit CCTV në ambientet e Zyrave Lokale të Gjendjes Civile. Kjo, pasi qëllimi i përpunimit i deklaruar nga ana juaj lidhur me garantimin e sigurisë së Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile është i ligjshëm dhe përbën interes publik. Por, është e rëndësishme që përpunimi i të dhënave nëpërmjet sistemit CCTV të kryehet në përputhje dhe zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 mbi "*Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*", i ndryshuar.

Në këtë kuadër vlerësojmë:

- Të merren të gjitha masat e sigurisë fizike dhe organizative për të garantuar të dhënat që përpunohen nëpërmjet sistemit CCTV. Për këtë, të hartohen rregulla të veçanta lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit CCTV dhe masat e sigurisë, ose ato të përfshihen në rregulloren e posaçme për mbrotjtjen e të dhënave personale;
- Aksesit në të dhënat personale (pamjet) të administruara në serverat e sistemit CCTV të jetë i kufizuar dhe për një numër të caktuar punonjësish;

- Personat që do kenë akses në të dhëna duhet të nënshkruajnë deklaratën e konfidencialitetit;
- Në të gjitha ambientet e survejuara duhet të vendosen tabelat informuese për sistemin CCTV sipas standardit të miratuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 3, të sipërcituar, të publikuar edhe në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit www.idp.al ;
- Kamerat duhet të pozicionohen në një formë të tillë që të kenë një impakt sa më të ulët në privatesi. Kjo, nënkupton që kamerat nuk mund të vendosen në zyra që nuk kanë kontakt me qytetarët apo që nuk ofrojnë shërbime ndaj qytetarëve. Gjithashtu, kamerat nuk mund të pozicionohen në vende publike jashtë zonës së mbulimit të institucionit (trotuare dhe rrugë).
- Periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të përcaktuar nga ana juaj i cili është në përputhje të plotë me atë çfarë parashikon udhëzimi i lartpërmendur.
- Gjithashtu, të realizohet përditësimi i Formularit të Njoftimit në lidhje me këtë përpunim të ri të dhënash personale në përputhje me qëllimin. (referojuni për këtë nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

